


E drejta e fshirjes së të dhënave personale (E drejta për t'u harruar)



**E drejta e fshirjes së të
dhënave personale
(E drejta për t'u harruar)**

TITULLI:

**E drejta e fshirjes së të dhënave personale
(e drejta për t'u harruar)**

AUTOR:

Lëvizja FOL

VITI I BOTIMIT:

Shtator, 2023

PUBLIKUAR NGA:

Lëvizja FOL

WEBSITE:

www.levizjafol.org

ADRESA:

Andrea Gropa nr.35, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Të drejtat e autorit © 2023. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Ky raport u realizua me mbështetjen e Fondit për Zhvillimin e Komunitetit (CDF), në kuadër të projektit "Mbrojtja e të drejtave të njeriut përmes mbrojtjes së të dhënave: Forcimi i mediave dhe shoqërisë civile në Kosovë". Pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën ose qëndrimin zyrtar të SIDA-s ose qeverisë suedeze.

Përmbajtja

1. Hyrje _____	5
2. Metodologjia _____	6
3. "E drejta për t`u harruar" në Republikën e Kosovës _____	7
4. "E drejta për t`u harruar" në legjislacionet fqinje _____	8
5. "E drejta për t`u harruar" në Bashkimin Evropian _____	10
6. Praktika e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GjED) _____	11
7. Institucioni për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë – Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) _____	13
8. Pikëpamjet e Organizatave të Shoqërisë Civile mbi mbrojtjen e privatësisë dhe informimin e tyre mbi të drejtën për t`u harruar _____	16
9. Konkluzion _____	18



1. Hyrje

Privatësia si koncept social dhe kulturor i cili në vete ngërthen aspekte të rëndësishme jetësore, në mënyrë kronologjiko-kohore po fiton rëndësinë e vet jetike. Në këtë kuptim, duke marrë parasysh ndryshimet e shpejta të shumë segmenteve të shoqërisë, e sidomos zhvillimin e teknologjisë së informacionit dhe rritjen e përdorimit të internetit, gjithnjë e më tepër diskutohet mbi çështjet e privatësisë individuale dhe mbrojtjen e privatësisë nga ana e shtetit dhe shoqërisë. Prandaj, gjithmonë shtrohet nevoja e rregullimit ligjor të mbrojtjes së privatësisë si një nga të drejtat bazike të njeriut, sidomos kur privatësia tashmë paraqitet përveç se si vlerë individuale, edhe kolektive. Kësisoj, mbrojtja e të dhënave personale kohëve të fundit është ngritur në piadestalin më të lartë të mbrojtjes konstitucionale dhe ndërkombëtare juridike.

Fillimisht, ne kuadër të sistemit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në nenin 12 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut garantohet liria nga ndërhyrjet në privatësinë, familjen, shtëpinë dhe korrespondencën. Ne kuptim të njëjtë, edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në nenin 8 të saj e siguron të drejtën e respektimit "të jetës private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës" së një individ, e drejtë që mund të limitohet nga kufizime "në pajtim me ligjin" dhe që janë "të nevojshme në një shoqëri demokratike". Ndërsa, instrumenti themelor ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale në Bashkimin Evropian, na paraqitet Direktiva 95/46 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 24 tetorit 1995 për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale si edhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave, i cili na paraqitet si referim mbi rregullimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe vendos kuadrin rregullator-juridik që synon të vendosë një ekuilibër ndërmjet shkallës së lartë të mbrojtjes së privatësisë së individit dhe lëvizjes së lirë të ato të dhënave.

Ne kuptim nacional, e drejta e privatësisë në Kosovë është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht me nenin 36 të saj, e cila përfshin respektimin e jetës private dhe familjare, pacenueshmërinë e banesës, fshehtësinë e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimeve të tjera, dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

"E drejta për t'u harruar", si koncept ndër lidhet me të drejtën e individëve për të mos i'u përdorur të dhënat personale për shkak se të njëjtat nuk përputhen me qëllimet fillestare të mbledhjes së tyre. Ky koncept, pra, është i lidhur ngushtë me privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Për herë të parë në mënyrë normative, "E drejta për t'u harruar" u rregullua me 27 prill të vitit 2016 dhe filloj të zbatohet me 25 maj të vitit 2018, ku në vendet anëtare të Bashkimit Evropian hyri në fuqi Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (KE 2016/679).

Megjithatë, kjo e drejtë ende ndeshet me sfida të natyrave të ndryshme, veçanërisht në lidhje me balancimin e të drejtës për të harruar me të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të lirisë së informacionit. Ndërsa në anën tjetër, disa besojnë se kjo e drejtë është thelbësore për ruajtjen e privatësisë dhe integritetit të individëve. Pra e drejta për t'u harruar mund të shihet si një përprjekje për të balancuar lirinë e informacionit dhe të drejtat e privatësisë.

2. Metodologjia

Qëllimi i këtij punimi është vlerësimi i zbatimit eventual në praktikë të së drejtës për t'u harruar në kuadër të legjisllacionit kosovar, njëkohësisht duke e promovuar këtë të drejtë tek qytetarët e Republikës së Kosovës. E drejta e fshirjes apo e drejta për t'u harruar në suaza të konstelacionit të të drejtave për mbrojtjen e të dhënave personale paraqet një të drejtë tepër të rëndësishme për qytetarët për mbrojtjen të të drejtave të tyre personale dhe respektimit të privatësisë.

Për nevojat e raportit është zbatuar metoda e hulumtimit të çështjeve dhe debateve të fundit në sferën akademike të cilat për interes kanë mbrojtjen e të dhënave personale, në mënyrë që të shpërfaqet pasqyra e plotë e kuptimit dhe esencës së të drejtës për t'u harruar. Kësisoj, gjetja e materialeve dhe artikujve të ndryshëm mbi objektin të cilin na paraqitet në shtjellim ishte më se e domosdoshme për t'u arritur thelbi i sqarimit të kësaj problematike.

Raporti përmban edhe një analizë të akteve juridike ndërkombëtare dhe vendore të së drejtës së privatësisë, rregullimit ligjor në kuadër të Bashkimit Evropian të së drejtës për t'u harruar, si dhe të zgjidhjeve nacionale të shteteve fqinje dhe të Republikës së Kosovës mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe të së drejtës për t'u harruar.

Në këtë raport gjithashtu FOL ka përdorur metodën krahasuese, e cila gjen shprehje gjatë gjithë punimit, duke krahasuar zgjidhjet e ndryshme normative që i karakterizojnë legjisllacionet e ndryshme nacionale dhe burimet juridike ndërkombëtare.

Për të përmbushur qëllimet e këtij raporti, FOL ka përdorur edhe metodën empirike përkatësisht të mbledhjes së të dhënave nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës, organizatave jo-qeveritare dhe mediave. Kërkimi empirik është zbatuar me qëllim të njohjes me të afërt me problematikën dhe nivelin e informimit të tyre me këtë fushë.

3. "E drejta për t'u harruar" në Republikën e Kosovës

Për shkak të rëndësisë që ka, e drejta e fshirjes apo e drejta për t'u harruar është inkorporuar edhe në *Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në shkurt të vitit 2019, hartimi i të cilës është bërë plotësisht në përputhje me Rregulloren 2016/679 të Parlamentit Evropian.

Neni 16 i këtij ligji parasheh:



Subjekti i të dhënave ka të drejtën që të kërkojë nga kontrolluesi të bëjë fshirjen e të dhënave personale në lidhje me të, pa vonesë dhe kontrolluesi ka detyrimin të fshijë të dhënat personale, pa vonesë të panevojshme..."

Megjithatë, për ushtrimin e kësaj të drejte, ligjvënësi ka paraparë se duhet të përmbushet njëra prej këtyre shkaqeve:

- që të dhënat personale mos të jenë më të nevojshme në lidhje me qëllimet, për të cilat ato janë mbledhur ose përpunuar;
- që subjekti i të dhënave ka tërhequr pëlqimin mbi të cilin bazohet përpunimi i të dhënave personale;
- që subjekti i të dhënave ka kundërshtuar përpunimin dhe nuk ka shkaqe legjitime mbizotëruese për përpunim;
- që të dhënat personale të jenë përpunuar në mënyrë të paligjshme;
- që të dhënat personale duhet të fshihen për të përmbushur një detyrim ligjor, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi;
- që të dhënat personale të jenë mbledhur në lidhje me ofertën e shërbimeve të shoqërisë së informacionit.

Gjithashtu, ashtu siç ka paraparë ligjvënësi në paragrafin 3 të nenit 16 të këtij ligji, kjo e drejtë nuk mund të ju njihet personave nëse ka të bëjë me:

- ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes dhe informimit;
- përmbushjen e një detyrimi ligjor që kërkon përpunimin, ose për përmbushjen e një detyre në interesin publik ose në ushtrim të autoritetit zyrtar të veshur kontrolluesit;
- për shkaqe të interesit publik në sferën e shëndetit publik;
- për qëllime arkivimi në interesin publik ose qëllime të kërkimit shkencor ose historik, ose qëllime statistike;
- për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore.

Megjithatë, ligjvënësi nuk ka paraparë ndonjë afat brenda të cilit kontrolluesi ka për obligim që të shlyej të dhënat personale nga dita e parashtrimit të kërkesës për shlyerje të këtyre të dhënave.

4. "E drejta për t'u harruar" në legjislacionet fqinje

Ligji i Republikës së Shqipërisë

Ligji nr. 9887 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Shqipërisë, i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në mars të vitit 2008, dhe është ndryshuar/plotësuar në vitin 2012 dhe 2014, në kuadër të nenit 13 të tij ka paraparë "*Të drejtën për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen*".

Paragrafi 1 i kësaj dispozite përcakton se:



Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë bllokimin korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, pa pagesë kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji".

Pra për dallim nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Kosovës, i cili çështjen e të drejtës së fshirjes e trajton në kuadër të nenit 16 dhe çështjen e të drejtës së korrigjimit në kuadër të nenit 15, ligjvënësi shqiptar e ka trajtuar edhe çështjen e korrigjimit, bllokimit dhe të fshirjes në kuadër të një neni.

Gjithashtu, ligjvënësi shqiptar nuk ka trajtuar çështjen se kur nuk mund të zbatohen dispozitat për fshirjen, korrigjimin apo bllokimin e të dhënave, siç trajtohen në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës.

Paragrafi 2 i kësaj dispozite përcakton se:



Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e bllokimit, korrigjimit apo të fshirjes".

Pra ndryshe nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës, ligjvënësit e Republikës së Shqipërisë e kanë paraparë edhe afatin brenda të cilit kontrolluesi duhet të informoj subjektin për mundësinë e fshirjes, kontrollimit apo korrigjimit.

Paragrafi 3 i kësaj dispozite parasheh se:



Kur kontrolluesi nuk bën bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të kërkuara prej tij, subjekti i të dhënave ka të drejtë të ankohet te komisioneri."

Pra, ndryshe nga ligji vendor, që në kuadër të të drejtës së fshirjes nuk e trajton çështjen e ankesës por e njëjta nënkuptohet nga dispozita e nenit 91 të ligjit, ligjvënësi shqiptar këtë çështje e ka përmendur në kuadër të nenit 13.

Pra, si përfundim, mund të thuhet se Shqipëria e ka miratuar ligjin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe e parasheh të drejtën për t'u harruar në kuadër të saj, megjithatë nevojitet harmonizim i mëtejshëm me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave.

Ligji i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Ligji nr. 42/20 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Maqedonisë së Veriut¹, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me 16 shkurt 2020, çështjen e të drejtës së fshirjes së të dhënave personale e trajton në kuadër të nenit 21, të titulluar "E drejta për shlyerje - e drejta që të harrohet".

Paragrafi 1 i kësaj dispozite parasheh se:



Subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të kërkojë nga kontrollori t'i shlyejë të dhënat personale të tij me ç'rast kontrollori ka për obligim t'i shlyejë të dhënat personale në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për shlyerje...".

Pra, ndryshe nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Kosovës, ligjvënësit në Maqedoninë e Veriut e kanë paraparë periudhën 30 ditore nga dita e parashtrimit të kërkesës për të shlyer të dhënat personale.

Njëjtë sikurse Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Kosovës, edhe ky ligj ka paraparë të njëjtat kushte për zbatimin e të drejtës për t'u harruar (të dhënat personale nuk janë të nevojshme për qëllimet për të cilat janë grumbulluar ose përpunuar në mënyrë tjetër; subjekti i të dhënave personale e tërheq pëlqimin e vet mbi të cilin bazohet përpunimi i të dhënave; subjekti i të dhënave personale paraqet kundërshtim të përpunimit; të dhënat personale kanë qenë të përpunuara në mënyrë të paligjshme; të dhënat personale duhet të shlyhen me qëllim të respektimit të obligimit të përcaktuar me ligjin i cili ka të bëjë me kontrollorin; të dhënat personale janë grumbulluar në lidhje me ofertën e shërbimeve të shoqërisë informatike).²

Gjithashtu, paragrafi 2 i këtij neni parasheh se *kur kontrollori i ka shpallur publikisht të dhënat personale dhe është i detyruar që t'i shlyejë të dhënat personale, atëherë kontrollori ndërmerr veprime teknike që t'i njoftoj kontrollorët tjerë të cilët i përpunojnë të dhënat personale se subjekti i të dhënave personale ka kërkuar shlyerjen e të gjitha linqeve ose kopjeve ose reproduksioneve të të dhënave personale nga ata kontrollorë, duke i marrë parasysht teknologjinë e arritshme dhe shpenzimet e zbatimit.*

Pra detyrimin për të njoftuar edhe kontrollorët tjerë për të fshirë të dhënat personale, ligji i Maqedonisë së Veriut e ka përcaktuar ngjashëm sikurse Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu edhe paragrafi 3 i kësaj dispozite, në mënyrë të ngjashme sikurse Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës, parasheh rastet kur dispozitat e këtij neni nuk mund të zbatohen.

Pra, mund të thuhet se çështja e të drejtës për t'u harruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndryshe nga Republika e Shqipërisë, është e rregulluar në përputhje të plotë me kërkesat e Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (KE 2016/679) të Bashkimit Evropian.

1 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligji Nr. 42/20 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2 Po aty, neni 21, par. 1.

5. "E drejta për t'u harruar" në Bashkimin Evropian

Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (General Data Protection Regulation) u miratua nga Parlamenti Evropian me 14 prill të vitit 2016 dhe filloj të zbatohet me 25 maj të vitit 2018 në të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave zëvendësoi Direktivën e BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave të vitit 1995. Rregullorja e re fokusohet në mbajtjen më transparente të bizneseve dhe zgjerimin e të drejtave të privatësisë së subjekteve të të dhënave.³

Kjo rregullore, përkatësisht neni 17 i saj, u jep individëve të drejtën që të kërkojnë fshirjen e të dhënave personale të tyre dhe organizatat/institucionet kanë detyrimin ta bëjnë këtë, përveç në rastet e kur: të dhënat personale që mban kompania/organizata nevojiten për të ushtruar të drejtën e lirisë së shprehjes; ekziston një detyrim ligjor për t'i mbajtur ato të dhëna; për shkak të interesit publik (p.sh. për shkak të shëndetit publik, për qëllime kërkimore shkencore, për qëllime statistikore, historike etj.).

Pra, kjo rregullore u jep individëve të drejtën të kërkojnë që të dhënat personale që janë të pasakta, të pavërteta, ose të vjetra të hiqen ose të përditësohen, dhe që shërbyesit e internetit të ndërtojnë mekanizma për t'i larguar informacionet e vjetra që nuk janë më relevante.

Procesi i përshtatjes së ligjeve të shteteve anëtare dhe të shteteve që synojnë të anëtarësohen në Bashkimin Evropian me këtë rregullore nuk është finalizuar ende. Disa prej vendeve janë në proces të përshtatjes së ligjeve të tyre, ndërsa të tjerat janë tashmë në proces të zbatimit.

³ Për më tepër, shih: <https://www.techtarget.com/ëhatis/definition/General-Data-Protection-Regulation-GDPR#:~:text=GDPR%20ësas%20ap-proved%20by%20the,privacy%20rights%20of%20data%20subjects>.

6. Praktika e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED)

RASTI: Google Spain SL kundër Mario Costeja González

Ky rast ka të bëjë me një qytetar spanjoll, respektivisht z. Mario Costeja González, i cili ankohej se kur në Google kërkonte emrin e tij, në një nga rezultatet që dilnin, ishin çështjet mbi problemet financiare dhe borxhet që z. Gonzales kishte. Prandaj, artikujt flisnin mbi pronat që ishin vënë në ankand publik. Ky ishte një version elektronik i dy shpalljeve të shtypura në gazetën "La Vanguardia Ediciones" në vitin 1998, numrat e së cilës më vonë ishin bërë edhe në formë elektronike. Sipas tij, informacionet e publikuara shkelnin privatësinë e tij dhe nuk ishin më të rëndësishme.

Në nëntor të vitit 2009, z. Gonzales i ishte drejtuar gazetës duke kërkuar nga ata që të largojnë këto të dhëna nga ueb-faqja e gazetës pasi kjo çështje ishte zgjidhur para shumë vitesh. Megjithatë, botuesi kishte refuzuar një gjë të tillë duke pretenduar se ky botim lidhet me një Urdhër të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale të Spanjës që e ndalonte një gjë të tillë.

Në mars të vitit 2010, qytetari spanjoll të njëjtën kërkesë e paraqiti tek Google Spain, të cilët i kishin thënë palës që t'i drejtohet kompanisë amë, Google Inc në SHBA, pasi janë ata që merren me shërbimin e kërkimeve në internet. Si rrjedhojë, personi në fjalë i është ankuar organit shtetëror për mbrojtjen e të dhënave (*Agencia Española de Protección de Datos - në tekstin e mëtejshëm: AEPD*) me të njëjtën kërkesë.

AEPD kishte mbështetur kërkesën e palës dhe kishte urdhëruar Google-në që të fshinte të gjitha të dhënat nga databaza e tyre, por kishte refuzuar ankesën ndaj gazetës pasi ata ishin të obliguar me ligj që të botonin një të dhënë të tillë. Pastaj, Google i është ankuar me dy ankesa të ndryshme në Gjykatën e Lartë në Spanjë, e cila më të pranuar ankesën ka ndaluar çështjen dhe ka parashtruar disa pyetje në GJED (Gjykata Evropiane e Drejtësisë).⁴

Gjykata kompetente spanjolle ka parashtruar pyetje në GJED duke kërkuar interpretimin e dispozitave ligjore të Direktivës 95/46/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 24 tetor 1995 për mbrojtjen e individëve përkritazi me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjes së lirë të të dhënave.

GJED vendosi për këtë rast më 13 maj 2014.⁵ Në arsyetimin e dhënë, gjykata së pari shtjelloi dispozitat ligjore dhe përmend qëndrimet e palëve në procedurë dhe të palëve të interesuara. Në paragrafin 96 të Vendimit, gjykata, duke u ndërlidhur me shtjellimin e dispozitave ka theksuar: "... gjatë vlerësimit të kërkesave të tilla të bëra për të kundërshtuar përpunimin ... në veçanti duhet të shqyrtohet nëse subjekti i të dhënave ka të drejtë që informatat që lidhen me të personalisht nuk duhet, në këtë kohë, të lidhen me emrin e tij në listën e rezultateve të paraqitura..."⁶

Gjithashtu në të njëjtin paragraf thuhet që interesi legjitim i shfrytëzuesve të internetit për qasje në informata duhet të balancohet me të drejtat themelore që burojnë nga nenet 7 dhe 8 të Konventës.

4 The case Google Spain v AEPD and Mario Costeja Gonzalez of the Court of Justice of the European Union: A brief critical analysis, 20 qershor, 2018.

5 Judgment of the Court (Grand Chamber), 13 May 2014.

Google Spain SL and Google Inc. v Agencia Española de Protección de Datos (AEPD) and Mario Costeja González, In Case C131/12.

6 Judgment of the Court (Grand Chamber), 13 May 2014.

Google Spain SL and Google Inc. v Agencia Española de Protección de Datos (AEPD) and Mario Costeja González, In Case C131/12, par. 96.

Me fjalë të tjera, Gjykata gjeti që këto të drejta themelore jo vetëm që mbisundojnë interesin ekonomik të operatorit të kërkuesit por edhe interesin e shoqërisë në përgjithësi. Lidhur me çështjen e paraqitur, duke marrë parasysh që rasti kishte ndodhur para 16 vjetësh, sensitivitetin e jetës private dhe të tjera, Gjykata Evropiane e Drejtësisë vendosi që e drejta për t'i marrë këto informata nuk do të duhej më të ishte e lidhur me emrin e ankuesit. Rrjedhimisht, pasi në këtë rast nuk ekzistonte ndonjë rast i veçantë që do të arsyetonte interesin shoqëror, Gjykata vendos që këto lidhje të fshihen nga lista e rezultateve.

Përfundimisht në vendim, Gjykata tha se subjekti i të dhënave ka të drejtë që të kërkojë informatat e tilla të mos jenë në dispozicion të publikut të gjerë. Megjithatë, sipas vendimit, ky përjashtim nuk do të vlente nëse përzierja me të drejtat e tij themelore do të ishte e arsyetuar me interesin e përgjithshëm shoqëror.⁷

Pasojat e vendimit C131/12 të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë

Vendimi në çështjen Google Spain kundër z. Mario Costeja González përbën një pikë referimi në mbrojtjen e të dhënave personale në nivel evropian, por edhe në atë ndërkombëtar. Google, i cili përbën një nga kontroluesit më të spikatur të të dhënave personale, ka vendosur një procedurë për aksesin e shpejtë dhe të lehtë të përdoruesve të saj në të drejtën për t'u harruar. Të gjithë përpunuesit e të dhënave personale janë të detyruar ta respektojnë atë dhe të gjithë subjektet e të dhënave mund ta gëzojnë atë, me kufizime të caktuara.⁸

Vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, pra, shënoj një kthesë të rëndësishme në mbrojtjen e privatësisë në përgjithësi, dhe në zbatimin e të drejtës për të kërkuar fshirjen e të dhënave personale në veçanti. Ky vendim ka pasur implikime të mëdha në atë se si informacionet janë trajtuar në internet, si dhe ka krijuar precedentin e rëndësishëm të zbatimit të kësaj të drejte dhe ka përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve/kompanive për trajtimin e kërkesave për fshirje të të dhënave personale.

Si rezultat i këtij vendimi, Google, si pala e prekur drejtpërdrejtë me atë vendim, menjëherë e ka lansuar një ueb-faqe të re në të cilën qytetarët e BE-së kanë të drejtë të kërkojnë që Google të largojë emrin e tyre nga lista e gjetjeve të kërkuesit.⁹ Sipas të dhënave nga vetë Google, deri në dhjetor të vitit 2022 janë pranuar afër 430,000 kërkesa për fshirje të të dhënave personale nga google.¹⁰

Gjithashtu, rezultat tjetër i vendimit të GjED-së është se autoritetet në Mbretërinë e Bashkuar kanë urdhëruar largimin edhe të artikujve të tjerë që kishin të bënin me rastet e larguara, por që ishin të një date të mëvonshme.¹¹

⁷ Ibid. par. 99.

⁸ The case Google Spain v AEPD and Mario Costeja Gonzalez of the Court of Justice of the European Union: A brief critical analysis, 20 qershor, 2018.

⁹ <https://support.google.com/transparencyreport/answer/7347822?hl=en>

¹⁰ <https://transparencyreport.google.com/user-data/overview?hl=en>.

¹¹ <https://www.theguardian.com/technology/2015/aug/20/google-ordered-to-remove-links-to-stories-about-right-to-be-forgotten-removals?CMP=EMCNEEML661912>

7. Institucioni për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë – Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP)

Agjencia për Informim dhe Privatësi është institucion i pavarur, përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Pra, çdo subjekt i të dhënave që pretendon se i është shkelur privatësia apo se përpunimi i të dhënave të tij personale është bërë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të paraqesë ankesë tek ky institucion.

Sipas Raportit Vjetor të Punës së këtij institucioni, vetëm gjatë vitit 2022 Agjencia ka pranuar 145 ankesa në lidhje me shkeljen e të dhënave personale. Natyra e ankesave të pranuar në AIP gjatë vitit 2022 ka qenë kryesisht për përpunimin e të dhënave personale nga ana e kontrolluesve, me ç'rast të dhënat e tyre janë përpunuar me qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë, përpunimi i paautorizuar i të dhënave përfshirë edhe të dhënat e ndjeshme, përpunim i të dhënave përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë, dhe keqpërdorim i të dhënave personale, që përfshijnë përpunimin e të dhënave pa pëlqimin e subjektit, përpunimin e të dhënave personale përmes rrjeteve sociale, si dhe përpunimi i të dhënave jo të sakta.¹²

Këto ankesa kanë qenë kryesisht të orientuara ndaj institucioneve qendrore, institucioneve lokale, sektorit bankar, sektorit mikrofinanciar, kompanive të sigurimeve, sektorit shëndetësor, qendrave tregtare, etj. Ndaj institucioneve publike ka pasur gjithsej 32 ankesa, ndërsa ndaj institucioneve private 113 ankesa.

Në Figurën e mëposhtme është shfaqur numri i ankesave të drejtuara institucioneve publike dhe atyre private gjatë vitit 2022.




Figura 1. Numri i ankesave për shkelje të të dhënave personale të bëra në Agjencinë për Informim dhe Privatësi gjatë vitit 2022

12 Agjencia për Informim dhe Privatësi, Raporti Vjetor i Punës për vitin 2022.

Gjatë vitit 2022, AIP kishte nxjerrë 172 vendime për mbrojtjen e të dhënave personale, ku 23 vendime janë lëshuar ndaj institucioneve publike dhe 149 ndaj institucioneve private. Në mënyrë grafike, numri i vendimeve ndaj institucioneve publike dhe private është paraqitur edhe në figurën e mëposhtme.




Figura 2. Numri i vendimeve për shkelje të të dhënave personale të nxjerra nga Agjencia për Informim dhe Privatësi gjatë vitit 2022

Në mesin e këtyre vendimeve të nxjerra, 8 prej tyre janë vendime për shqiptim të gjobave kundërvajtëse, vlera totale e të cilave ka arritur në 169,000.00 euro. Nga këto gjoba, 4 janë shqiptuar ndaj institucioneve publike dhe 4 ndaj institucioneve private. Ndërsa, në vitin 2021, AIP nuk ka shqiptuar asnjë gjobë kundërvajtëse.

Numri i gjobave të shqiptuara ndaj institucioneve publike dhe private gjatë vitit 2022 është paraqitur edhe në figurën e mëposhtme.




Figura 3. Numri i gjobave për shkelje të të dhënave personale të shqiptuara nga Agjencia për Informim dhe Privatësi gjatë vitit 2022

Sa i përket të drejtës për t'u harruar në veçanti, vlen të përmendet rasti i qershorit të këtij viti, ku një qytetar i Republikës së Kosovës që kishte aplikuar në pozitën e zyrtarit ligjor në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, ishte ankuar në AIP ndaj Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për shkak se kur kërkonte emrin e tij në internet, akoma i shfaqej në kuadër të listës së të papranuarve të shpallur nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Agjencia për Informim dhe Privatësi ka detyruar KGJK - në të largoj këto lista, duke tërhequr vërejtjen se publikimi i listave nga KGJK-ja apo ndonjë institucion tjetër publik me kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër në faqe të internetit e aq më pakë publikimi i listës me kandidatët që nuk plotësojnë kriteret për vazhdimin e procedurave të mëtutjeshme të rekrutimit, nuk kanë kurrfarë baze ligjore.

Këtë vendim AIP e arsyetoj me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik, e në veçanti të mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë.

Për nevojat e përpilimit të këtij raporti, FOL ka intervistuar edhe zyrtarët e agjencisë në lidhje me situatën në Kosovë sa i përket mbrojtjes së të dhënave personal në përgjithësi, dhe të drejtës për t'u harruar në veçanti¹³.

Zyrtarët e Agjencisë për Informim dhe Privatësi pohojnë se Republika e Kosovës është vendi i parë në rajon që ka harmonizuar Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me Rregulloren e Përgjithshme Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave e njohur si GDPR. GDPR ka hyrë në fuqi më datë 25 maj 2018, ndërsa Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka hyrë në fuqi më 25 shkurt 2019.

Njekohësisht, pikëpamjet e Agjencisë mbi atë se sa është niveli i vetëdijes së institucioneve, organizatave dhe qytetarëve në lidhje me "të drejtën për t'u harruar", shtrihen në drejtim të asaj se përgjithësisht institucionet, organizatat dhe qytetarët nuk kanë shumë informacione mbi këtë të drejtë, kjo për arsye se në Kosovë kjo është një e drejtë e re e paraparë dhe pak e njohur nga qytetarët. Së fundmi, Agjencia ka publikuar një doracak për mbrojtjen e të dhënave personale në të cilën përveç tjerash trajtohet edhe e drejta për t'u harruar.

Sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë mbi numrin e ankësive të paraqitura para Agjencisë për Informim dhe Privatësi në lidhje me shkeljen e "të drejtës për t'u harruar", del se nga viti i kaluar Agjencia ka trajtuar një rast, në të cilën subjekti i të dhënave ka kërkuar realizimin e të drejtës për t'u harruar. Vendimin e nxjerrë nga Agjencia kontrolluesi i të dhënave e ka zbatuar dhe subjekti i të dhënave e ka realizuar të drejtën e tij.

Përkatësisht, mbi kufizimet dhe sfidat e zbatimit të e drejtës për të harruar në mjedisin online, Agjencia pohon se me rritjen dhe zhvillimin e teknologjisë dhe përdorimin e saj në masë të gjerë nga shoqëria, qasja dhe ekspozimi i të dhënave që identifikojnë subjektin e të dhënave është e gjerë. Përpunimi përmes platformave dhe mediave online paraqet sfidë në të ardhmen dhe për këtë nuk është paraparë ndonjë kufizim apo masë.

Në segmentin e ndërgjegjësimit të individëve mbi "të drejtën e tyre për t'u harruar" dhe për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi i paautorizuar i të dhënave personale, Agjencia është e qëndrimit se promovimi i të drejtave të individëve e sidomos i të drejtës për t'u harruar kërkon gjithpërfshirje më të zgjeruar jo vetëm institucionale, por këtu duhet angazhim edhe i akterëve të ndryshëm si media, OJQ, shoqëri civile, institucione edukative etj. Ndërsa shfrytëzimi i paautorizuar i të dhënave personale të subjekteve përbën shkelje të dispozitave ligjore dhe ligji ka paraparë masa me gjorbë kundërvajtëse për shkelësit e ligjit.

Pra, zyrtarët e institucionit përgjegjës për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale janë shprehur se ka mungesë të informimit të qytetarëve në lidhje me të drejtën për t'u harruar, meqenëse është e drejtë e re e paraparë në legjislacionin tonë; se agjencia gjatë vitit të kaluar ka trajtuar vetëm një ankesë për të drejtën për t'u harruar; se kërkohet gjithë përfshirje më e gjerë institucionale për promovimin e të drejtës për t'u harruar; dhe se ekspozimi i të dhënave që identifikojnë subjektin e të dhënave është zgjeruar me rritjen dhe zhvillimin e teknologjisë dhe me zgjerimin e përdorimit të saj nga shoqëria.

13 Intervistimi është bërë përmes parashtrimit të pyetjeve me shkrim.

8. Pikëpamjet e Organizatave të Shoqërisë Civile mbi mbrojtjen e privatësisë dhe informimin e tyre mbi të drejtën për t'u harruar

Për nevojat e përpilimit të këtij raporti, FOL ka intervistuar edhe përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile/mediat në lidhje me atë se sa e shohin të rëndësishme mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale, si dhe se si e vlerësojnë nivelin e tyre të informimit për të drejtën për të kërkuar fshirjen e të dhënave personale kur ato e kanë humbur qëllimin e publikimit, e çështje të tjera të ngjashme.

Nga **Instituti i Kosovës për Drejtësi** kanë thënë se, deri disa vite më parë, mbrojtja e të dhënave personale ka qenë një temë shumë pak e njohur dhe për të cilën shumë pak është diskutuar. Kjo situatë, ndër të tjera, ka bërë që niveli i njohurive të qytetarëve në lidhje me këtë temë të jetë shumë i ulët. Sipas tyre, fatmirësisht, kohëve të fundit vërehen hapa praktikë që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale dhe ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale.

Ata kanë theksuar se është shumë e rëndësishme që gazetarët të kenë njohuri të mjaftueshme në lidhje me fushën e të dhënave personale, përfshirë edhe të drejtën për tu harruar. Kjo pasi nisur nga natyra e punës që kanë gazetarët, potenciali i cenimit të të dhënave personale është shumë i lartë.

Sa i përket "të drejtës të tu harruar", nga IKD janë shprehur se ata tanimë e kanë institucionalizuar këtë të drejtë në operimin e përgjithshëm. Sipas tyre, kjo manifestohet në dy mënyra. E para është se në raportimet e "Betimi për Drejtësi" emrat e palëve të përfshira në raportime publikohen vetëm në rastet kur vet emri i palëve paraqet interes publik. Në rastin e dytë, është situata kur prano-

hen kërkesa nga palët për fshirje apo anonimizim të raportimeve të bëra paraprakisht.

Ndërsa nga **Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)** kanë thënë se rol të veçantë në realizimin e të drejtës së privatësisë tashmë po luan edhe Agjencia për Informim dhe Privatësi. Ky institucion viteve të fundit ka dëshmuar përpjekje të vazhduar për të vendosur rend dhe rregull si dhe mbrojtje të kësaj të drejtë sa herë që qytetarët kanë dëshmuar shkeljen e saj nga ana e autoriteteve qoftë publike apo edhe private.

Sipas KDI, sfidat kryesore në mbrojtjen e kësaj të drejte kryesisht manifestohen me informimin e pamjaftueshëm të qytetarëve mbi konceptet e mbrojtjes së të dhënave personale, sidomos mbi bazën ligjore të garantuar dhe mekanizmat përkatës institucional që kanë për kompetencë mbrojtjen e këtyre të dhënave.

Ndërkaq sa i përket nivelit të informimit të tyre si si organizatë, në lidhje me të drejtën për t'u harruar, nga KDI kanë thënë se si organizatë kemi njohuri të mjaftueshme mbi aspektin e legjislacionit bazë që garanton mbrojtjen e këtyre të drejtave si dhe mbi mekanizmat institucional që kanë fushëveprimtari në ofrimin e mbrojtjes së tillë.

Sipas KDI, gazetarët dhe aktivistët në përgjithësi duhet që në vazhdimësi të fitojnë njohuri të reja lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale në fjalë, e veçanërisht mbi konceptin e të drejtës për t'u harruar. Madje, sipas tyre, njohuritë e fituara tashmë duhet të jenë jo vetëm mbi aspektet bazike të legjislacionit dhe mekanizmave institucional që garantojnë mbrojtjen e tillë por edhe të kenë dijeni të posaçme mbi vendimet e jurisprudencës

së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe gjykatave vendore lidhur me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Në fund, nga KDI kanë thënë se të drejtën për të hequr informacionin e pasaktë e kanë kërkuar si organizatë disa here. Kryesisht kjo ka ndodhur ndaj disa mediave dhe portaleve online të cilave u janë drejtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë sepse kanë vërejtur se kanë cituar gabimisht ndonjë prononcim medial të tyre, apo ndonjë komunikatë ose analizë të publikuar nga KDI.

Nga **Organizata QOHU!** kanë thënë se mbrojtjen e të dhënave personale e vlerësojnë si shumë të rëndësishme dhe për këtë kujdesen që raportimet të kalojnë në disa filtra në mënyrë që të mos publikohet asgjë e cila nuk ka interes publik.

Sipas Organizatës Qohu!, mbrojtja e të dhënave personale të qytetarëve përballet me disa sfida, të cilat kryesisht vijnë për shkak të ekspozimit të shpeshtë të të dhënave pa asnjë kriter. Gjithashtu Problematike për ne si organizatë është gjithashtu edhe mos njohuritë e qytetarëve rreth mekanizmave që i mbrojnë ata ndaj ekspozimit të të dhënave.

Nga Organizata Qohu! kanë thënë se njohuritë për të drejtën për t'u harruar si organizatë i vlerësojnë si bazike, ndërsa në anën tjetër janë shprehur se është shumë e rëndësishme që gazetarët, aktivistët apo edhe hulumtuesit nga shoqëria civile të aftësohen rreth asaj se çka përmban interesi publik dhe çka jo, sidomos në trajtimin e çështjeve sensitive dhe jetën private. Çdo publikues duhet t'i njoh mirë rreziqet që vijnë nga publikimi pa kriter i të dhënave personale, sidomos për shkak që përhapja e shpejt e informacioneve dhe ri publikimi i tyre i shpejtë në media dhe rrjete sociale e vështirëson shumë largimin e tyre nga rrjeti online.

Nga **BIRN Kosova** kanë thënë se si organizatë janë shumë të përkushtuar në mbrojtjen e të dhënave personale për të gjitha palët sepse veprojnë si media dhe janë të njoftuar me dëmin që mund t'ju shkaktohet individëve nga ndërhyrjet e pa autorizuara dhe jo-proporcionale në privatësinë e palëve.

Sipas tyre, sfiduese është mungesa e njohurive të zyrtarëve publik, kontrolluesve të të dhënave personale që nuk janë të vetëdijshëm për rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale dhe gjithashtu si sfidë konsiderojnë se duhet të evidentohet edhe zvarritja e rasteve në gjykata.

Nga kjo organizatë janë shprehur gjithashtu se janë të përditësuar me legjislacionin vendor dhe të huaj që rregullon të drejtën për t'u harruar. Sipas tyre, parimet e GDPR-në kuadër të veprimtarisë së organizatës së tyre dhe kanë pasur disa raste kur bazuar në kërkesat e palëve kemi larguar të dhënat e tyre.

9. Konkluzion

E drejta për t'u harruar është temë e re në qarqet juridike dhe ekziston mungesë e theksuar e teksteve dhe literaturës së fokusuar për këtë problematikë. Kjo e drejtë po bëhet çdo ditë e më e rëndësishme në Evropë, përkatësisht në vendet e Bashkimit Evropian, e sidomos pas vendimit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, lidhur me rastin C131/12: Google Spain SL kundër Mario Costeja González.

Ky ishte rasti i një qytetari spanjoll, i cili që nga viti 2009 ankohej se kur në Google kërkonte emrin e tij, në një nga rezultatet që dilnin, ishin çështjet mbi problemet financiare dhe borxhet që Gonzales kishte. Gonzales, pasi i ishte refuzuar kërkesa nga gazeta për të hequr të dhënat në lidhje me të, i ishte drejtuar Google dhe së bashku me të i ishin drejtuar GjED-së. GjED gjeti se e drejta për të kërkuar fshirjen e të dhënave personale mbisundon jo vetëm interesin ekonomik të operatorit të kërkuesit por edhe interesin e shoqërisë në përgjithësi dhe si përfundim vendosi në favor të z. Gonzales, duke shënuar një kthesë të rëndësishme në mbrojtjen e privatësisë në përgjithësi, dhe në zbatimin e të drejtës për të kërkuar fshirjen e të dhënave personale në veçanti.

Vendimi C131/12 ka pasur implikime të mëdha në atë se si informacionet janë trajtuar në internet, si dhe ka krijuar precedentin e rëndësishëm të zbatimit të kësaj të drejte dhe ka përcaktuar përgjegjësitë e kompanive për trajtimin e kërkesave për fshirje të të dhënave personale.

Me 14 prill të vitit 2016 Parlamenti Evropian miratoj Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (General Data Protection Regulation), i cili filloj të zbatohet me 25 maj të vitit 2018 në të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave zëvendësoi Direktivën e BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave të vitit 1995. Rregullorja e re fokusohet në mbajtjen më transparente të bizneseve dhe zgjerimin e të drejtave të privatësisë së subjekteve të të dhënave.¹⁴

Kjo rregullore u jep individëve të drejtën që të kërkojnë fshirjen e të dhënave personale të tyre dhe organizatat/institucionet kanë detyrimin ta bëjnë këtë, përveç në rastet e kur: të dhënat personale që mban kompania/organizata nevojiten për të ushtruar të drejtën e lirisë së shprehjes; ekziston një detyrim ligjor për t'i mbajtur ato të dhëna; për shkak të interesit publik (p.sh. për shkak të shëndetit publik, për qëllime kërkimore shkencore, për qëllime statistikore, historike etj.).

Edhe Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Kosovës, në nenin 16 të tij, e ka parapa të drejtën për t'u harruar, bazuar në standardet e krijuara nga Bashkimi Evropian. Ligji gjithashtu ka paraparë shkaqet për të cilat mund të kërkohet fshirja e të dhënave personale, si dhe rastet në të cilat nuk mund të pranohet fshirja e të dhënave personale. Mirëpo ligji nuk ka paraparë ndonjë afati për fshirjen e të dhënave që nga parashtrimi i kërkesës, afate të cilat i kanë paraparë ligjet për mbrojtjen e të dhënave personale të Republikës së Shqipërisë dhe të Maqedonisë së Veriut.

Organizatrat e shoqërisë civile/mediat në përgjithësi janë shprehur se janë të informuar në lidhje me këtë të drejtë, por që nuk kanë zhvilluar aktivitete në drejtim të promovimit dhe të informimit të qytetarëve për ekzistimin e kësaj të drejte.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, në anën tjetër, është shprehur se që nga viti 2022 kanë pasur vetëm një ankesë në lidhje me fshehjen e të dhënave personale. Gjithashtu, agjencia është shprehur se institucionet, organizatat dhe qytetarët nuk kanë shumë informacione mbi këtë të drejtë, dhe se promovimi i kësaj të drejte kërkon gjithpërfshirje më të zgjeruar jo vetëm institucionale, por edhe angazhim të akterëve të ndryshëm si media, OJQ, shoqëri civile, si dhe të institucioneve edukative.

¹⁴ Për më tepër, shih: <https://www.techtarget.com/ehatis/definition/General-Data-Protection-Regulation-GDPR#:~:text=GDPR%20ëas%20ap-proved%20by%20the,privacy%20rights%20of%20data%20subjects>.

